

VENDIM
Nr. 80, datë 5.2.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 788, DATË 11.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN DHE RREGULLAT E DETAJUARA PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN E SHPËRBLIMIN FINANCIAR TË KOMISIONIT QENDROR TË STATUSIT ‘DËSHMOR I ATDHEUT’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 5, të nenit 10, të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 788, datë 11.12.2019, Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen dhe rregullat e detajuara për organizimin, funksionimin e shpërblimin financiar të Komisionit Qendror të Statusit ‘Dëshmor i atdheut’”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Në pikën 4 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:
 - i. Në shkronjën “a”, pas fjalëve “... të dërguar ...” shtohen “... përmes portalit “*e-Albania*” ...”;
 - ii. Në shkronjën “b”, pas fjalës “... kërkuese ...” shtohen fjalët “... të dërguara përmes portalit “*e-Albania*” ...”;
 - iii. Në shkronjën “c”, fjalët “... me shkrim ...” zëvendësohen me “... përmes portalit “*e-Albania*” ...”;
 - iv. Në shkronjën “ç”, pas fjalës “... njofton ...” shtohen fjalët “... përmes portalit “*e-Albania*” ...”;
 - v. Në shkronjën “g”, fjalët “... me shkresë zyrtare ...” zëvendësohen me “... përmes portalit “*e-Albania*” ...”.
- b) Në pikën 5, fjalët “... i paraqitet ...” zëvendësohen me “... i dërgohet nëpërmjet portalit “*e-Albania*” ...”.
- c) Në fund të pikës 6, shtohen fjalët “... nëpërmjet portalit “*e-Albania*”.
- ç) Në pikën 7, pas fjalëve “... këshillit të qarkut, këshillit bashkiak dhe prefektit.” shtohen “... nëpërmjet portalit “*e-Albania*”.

d) Pas pikës 9 shtohet pika 9.1, me këtë përmbajtje:

“9.1 Deri në momentin e krijimit të infrastrukturës së nevojshme teknike për ofrimin e shërbimeve përmes portalit “*e-Albania*”, pritja dhe trajtimi i aplikimeve do të vijojë të kryhet sipas mënyrave dhe mjeteve ekzistuese.”.

dh) Kudo në tekstin e vendimit, fjala “propozimi/propozimin/propozimit” zëvendësohet përkatësisht me “kërkesa/kërkesën/kërkesës” dhe fjala “propozues/propozuese” zëvendësohet përkatësisht me “kërkues/kërkuese”.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama